

LIGJ
Nr. 80/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 031, DATË 11.12.2008 “PËR
SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Kontrolli i respektimit të kriterëve ligjore

Kontrolli për verifikimin e respektimit të kriterëve ligjore nga ana e përmbaruesve gjyqësorë privatë bëhet nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveç kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj, duke garantuar të drejtën për t’u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur.”.

Neni 2

Në nenin 54, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Masat disiplinore të parashikuara në këtë ligj janë dënime administrative kryesore.”.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8039, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani